



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:237666

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636390

A.C.nr.2598/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci – anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit H.S. nga fshati V..., Komuna Skenderaj, që e përfaqëson me autorizim A.F, avokat me seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Komuna Skenderaj-Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson Enver Çerkini, në çështjen kontestimore për pagesën e pagave pas largimit nga puna, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të parashtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – dega në Skenderaj – departamenti i përgjithshëm– divizioni civil, C.nr.454/2018 datë 19.10.2020, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 29.04.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit H.S. nga fshati V..., Komuna Skenderaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – dega në Skenderaj – departamenti i përgjithshëm– divizioni civil, C.nr.454/2018 datë 19.10.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – dega në Skenderaj, me aktgjykimin C.nr.454/2018 datë 19.10.2020, ndër të tjera ka vendosur si vijon :

“...**REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit H.S. nga fshati V..., komuna Skenderaj, për pagesën e pagave për periudhën e largimit nga puna prej dt.31.08.2016 deri në pensionimin e tij me dt. 29.05.2020, sepse padia është parashtruar në gjykatë pas përfundimit të afatit ligjorë për ushtrim të kërkesës në procedurën e mbrendëshme tek punëdhënësi për mbrojtëjen të së drejtës siq parashifet e Ligjin e Punës .

Secila palë i bartë shpenzimet e veta te procedurës...”

Kundër aktgjykimit C.nr.454/2018 datë 19.10.2020 të marrë nga Gjykata në Mitrovicë – dega në Skenderaj, në afat ligjor paditësi, me datë 10.11.2020, ka paraqitur ankesë, për shkak të: *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale*, me të cilën ankesë ndër të tjera ka kërkuar që të aprovet ankesa si e bazuar, të priset aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen ta kthej në rivendosje dhe rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose të vendoset meritorisht, ku padia dhe kërkesëpadia të bazohet në tersi si e pabazuar.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se :

- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi H.S., ka parashtruar në gjykatën e shkallës së parë me datë 04.12.2018, kundër të paditurës Komuna e Skenderajt, padi kontest pune.

E paditura ka paraqitë në Gjykatë përgjigje në padi me datë 03.04.2019, ku ndër të tjera në përgjigje në padi ka deklaruar se “...konsideroj se padia dhe kërkesëpadia janë të parashkruara dhe si të tillë gjykata duhet refuzuar...”.

Gjykata e shkallës së parë, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datë 19.10.2020, dhe administrimit të provave, e ka refuzuar si të pa bazuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar ndër të tjera si vijon “...Gjykata në rastin konkret fillimisht lëshuar në vlerësimin e provave të ofruara nga pala e paditur se padija a është parashtruar në përputhje me dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Nga provat në shkresat e lëndës ,vërtetimi i lartpërmendur dhe kontrata e punës për vitin shkollor 01.09.2015 deri me 31.08.2016 nr.519 e protokolluar më dt. 28.10.2015, vërtetohet se paditësi dhe e paditura e kanë lidhur kontratën e punës për mësimdhënie për vitin shkollor me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me kontratë në përputhje më Ligjin e punës cila kontrate pas kësaj date nuk është vazhduar. Pala paditëse përmes përfaqësuesit me autorizim me dt.18.07.2019 ka ushtruar kërkesë te e paditura për kthim ne vendin e punës dhe kompensim të pagave. Nga e paditura me dt. 14. 10.2019 e ka marrë përgjegjëjen nr.07-

112/01-0063/19i nga është e njoftuar se kërkesa është paraqitur pas afatit ligjor siq është përcaktuar me Ligjin e punës nr.03/L-212, pikërisht me nenin 78...”

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në këtë procedurë kontestimore nuk është kontestuese se palët ndërgjyqëse me kontratën pune nr.519 të lidhur me datë 28.10.2015 e cila kontratë ka qenë e lidhur me kohë të caktuar dhe atë deri me datë 31.08.2016 ku me kontratë palët ndërgjyqëse i kanë rregulluar të drejtat dhe detyrimet e tyre që dalin nga marrëdhënia e punës si vendin e punës, kohëzgjatjen e punës, gradën e pagesës, dhe të drejtat tjera që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Po ashtu nuk është kontestuese se palët ndërgjyqëse pas kontratës pune nr.519 të lidhur me datë 28.10.2015 nuk kanë lidhë kontratë tjetër të punës.

Në nenin 2 të Ligjit nr. 04/l-077 për marrëdhëniet e detyrimeve në mënyrë decisive thuhet se: *“1. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre. 2. Pjesëmarrësit mund t'i rregullojnë marrëdhëniet e tyre të detyrimeve ndryshe nga ajo që është paraparë me këtë ligj, për derisa nuk rezultojnë diçka tjetër nga dispozitat e këtij ligji ose të kuptimit dhe qëllimit të tyre”*.

Ndërsa në nenin 15 të Ligjit nr. 04/l-077 për marrëdhëniet e detyrimeve në mënyrë decisive thuhet se: *“Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës”*.

Andaj meqë palët ndërgjyqëse nuk kanë pasë kontratë pune tjetër të nënshkruar, Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Pretendimi ankimor i paditësit se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i kjashtë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës paditëse se kemi të bëjmë me shkelje të procedurës, dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Lidhur me pretendimet tjera ankimore të paditësit të parashtruara në ankesë, Gjykata e Apelit i mori parasysh dhe gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.2598/21 datë 29.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi